

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	LIVE: PDK-ja bojkoton vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit
ADRESA	https://albeu.com/kosove/live-pdk-ja-bojkoton-vazhdimin-e-seances-konstituive-te-kuvendit/1009287/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 08:20:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 08:18:40 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0c4adfd989af3b3f358267dc28bbdae891ffc385d32d4bbef75a437bf994b5b5
TEKSTI	aa895daa46f44de2b8ac44aaec6ffaf95115b8753672e6235a787ce86b3e318
PAMJA	17dcb0cd3f5107bb85a4b4365576d9d2e1c58c3e2ac4d3030a0d532fee9bebf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	88c5d09918dc9b59ad4944cd21a928a5b8c9deed5cb8e708a59a461a91cfd960
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4dbb247c3ea631ff8f2707e6b1f894f950e04cf248d4447a7ba057e4086fe8b1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/88c5d09918dc9b59ad4944cd21a928a5b8c9deed5cb8e708a59a461a91cfd960>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LIVE: PDK-ja bojkoton vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit



Partia Demokratike e Kosovës ka njoftuar se nuk do të marrë pjesë në vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës, të caktuar për sot, më 13 shtator 2026.

Përmes një komunikate për media, PDK-ja bëri të ditur se do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për zvarritjen e procesit të konstituimit të Kuvendit.

Vendimi u bë publik pasi Lëvizja Vetëvendosje njoftoi se do të votojë për dy kandidatët e propozuar nga PDK-ja dhe LDK-ja për postet e nënkryetarëve, Viora Çitakun dhe Kujtim Shalën.

PDK-ja deklaroi se procesi është shoqëruar me shkelje afatesh, bllokime të përsëritura dhe kushte të reja politike të vendosura nga Lëvizja Vetëvendosje.

Sipas PDK-së, Kuvendi duhej të konstituohet brenda afatit 30-ditor, përkatësisht më së largu deri më 7 gusht, në përputhje me Kushtetutën dhe Aktgjykimin KO124/25 të Gjykatës Kushtetuese. Kjo parti vlerëson se LVV-ja nuk e respektoi këtë afat dhe më pas caktoi një afat të ri, 6 shtatorin, i cili gjithashtu nuk u përmbush.

PDK-ja theksoi se, pavarësisht këtyre zhvillimeve, kishte pranuar të merrte pjesë në seancat e Kuvendit edhe pas përfundimit të afateve, me qëllim që procesi të përmbyllet, veçanërisht duke pasur parasysh 16 shtatorin dhe vendimin e madh që pritet në Hagë.

Kjo parti mori pjesë në seancat e 9 dhe 11 shtatorit, të thirrura me ftesë të Lëvizjes Vetëvendosje. Megjithatë, sipas PDK-së, të dyja seancat u penguan nga LVV-ja përmes arsyetimeve të reja lidhur me zgjedhjen e nënkryetarëve të opozitës.

PDK-ja tha se e kishte mbështetur kandidatin e LVV-së për nënkryetar të Kuvendit, ndërsa LVV-ja nuk e votoi kandidaten e PDK-së, pavarësisht premtimit publik. Sipas saj, kjo dëshmon se qëndrimet e Lëvizjes

të fundit /



LIVE: PDK-ja bojkoton vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit



Rimac zgjeron kontrollin mbi Bugatti-n pas marrëveshjes së ...



Tri ndeshje sot në Superligën e Kosovës, spikat përballja mes...



Real Madridi gjen një kandidat të mundshëm për të zëvendësuar...



Obama paralajmëron për rrezikun e IA-së: Duhet të mos lihet...



Woman Unknown" shpallet fitues i Luanit të Artë në Venezia,...



Apolonia, Luftëtari dhe ekipet e tjera zbresin sot në fushë, Bylis B...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Vetëvendosje ndryshojnë në varësi të interesave politike.

Partia Demokratike e Kosovës e konsideron të papranueshme që votimi për nënkryetarët të lidhet me mënyrën se si opozita do të votojë për Presidentin e Republikës. Në qëndrimin e saj thuhet se konstituimi i Kuvendit është detyrim kushtetues dhe nuk mund të kushtëzohet me marrëveshje politike.

PDK-ja njoftoi se nuk do të vazhdojë të marrë pjesë nga një seancë në tjetrën në një proces ku kushtet ndryshojnë vazhdimisht dhe shfaqen pengesa të reja. Ajo vlerëson se pjesëmarrja në një seancë tjetër nuk garanton përfundimin e procesit dhe as mungesën e kërkesave të reja.

Ekspertët e PDK-së, sipas komunikatës, po përgatisin rastin që do t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese dhe që do ta përfshijë procesin në tërësi. Deri në marrjen e vendimit nga kjo gjykatë, PDK-ja thotë se nuk do të marrë pjesë në seancat e Kuvendit.

Më herët, deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kishte kërkuar nga PDK-ja dhe LDK-ja që të ishin pjesë e seancës së sotme për konstituimin e legjislaturës së njëmbëdhjetë.

Para hyrjes në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, Kryeziu-Hyseni shpjegoi se LVV-ja e kishte ndryshuar qëndrimin për votimin e Vlorë Çitakut dhe Kujtim Shalës pas diskutimeve brenda grupit parlamentar dhe vendimit të kryesisë së partisë për të mbështetur këta dy emra, me qëllim zhblokimin e procesit.

Ajo tha se shpresonte që partitë opozitare ta ndryshonin qëndrimin dhe të merrnin pjesë në votim, duke iu referuar aktgjyqimit që, sipas saj, e bën pjesëmarrjen e deputetëve obligative për konstituimin e Kuvendit dhe vijimin e proceseve të tjera.

Në orën 09:53, deputeti i PDK-së, Arian Tahiri, nuk kishte dhënë një përgjigje përfundimtare nëse deputetët e kësaj partie do të merrnin pjesë në seancë. Ai deklaroi se grupi parlamentar po zhvillonte një takim dhe se vendimi do të bëhej i ditur shumë shpejt përmes një komunikate.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ishte i pari që hyri në objektin e Kuvendit, ku pritej të mbahej seanca konstituive.



Seanca ishte caktuar të niste në orën 10:00, ndërsa në rendin e ditës ishte pika e katërt, zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit.

Mbledhja u thirr nga kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, pas dështimit të votimit të Vlorë Çitakut në seancën e së premtes. Deputetët e LVV-së abstenuan atëherë për kandidaten e PDK-së, e cila nuk arriti të sigurote votat e nevojshme për postin e nënkryetares.

Në të njëjtën seancë, Kuvendi zgjodhi Ardian Golën nga LVV-ja si nënkryetar.

Pas dështimit të votimit të Çitakut, PDK-ja vendosi të mos merrte pjesë në seancat e mëtejshme konstituive. Disa orë më vonë u thirr edhe një seancë tjetër brenda së njëjtës ditë, por deputetët e PDK-së nuk morën pjesë.

LDK-ja kishte deklaruar se kandidatura e Kujtim Shalës nuk mund të hidhej në votim pa u votuar më parë kandidatura e PDK-së, duke kërkuar që procedura të ndiqte radhën përkatëse.

Të dielën në mbrëmje, LVV-ja njoftoi se do të mbështeste të dy kandidatët për nënkryetarë, Vlorë Çitakun e PDK-së dhe Kujtim Shalën e LDK-së. Nga kjo parti u shpreh shpresë se zgjedhja e tyre do t'i hapte rrugë vazhdimit të procesit institucional dhe nuk do të pengonte zgjedhjen e Presidentit të ardhshëm të Kosovës.

Megjithatë, PDK-ja e mbylli qëndrimin e saj me kërkesën që çështjen ta trajtojë Gjykata Kushtetuese, duke kundërshtuar afatet e shkelura, kushtet e reja dhe pazaret politike.

Shtuar më 13.09.2026 10:18

Tags: kuvendi , senace , vazhdimi



LVV-ja sqaron ndryshimin e qëndrimit për Çitakun dhe Shalën



LIVE: Kuvendi vazhdon sot seancën, në fokus zgjedhja e nënkryetarëve



Hoxhaj përshëndet 100 mijë shqiptarët që marshuan me UÇK-në në...



Halilaj për bllokimin e Kuvendit: Çështjet e Thaçit, Veselit dhe UÇK-së nuk...



Sadiku akuzon LVV-në për bllokim institucional: Po synojnë zgjedhjet e 27...



Ramadani: LVV-ja po e mban peng konstituimin e Kuvendit për të kalkuluar...



Kuvendi vazhdon sot seancën, në fokus zgjedhja e nënkryetarëve



LVV vendos të mbështesë nesër Çitakun dhe Shalën për nënkryetarë të Kuvendit



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.